



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt.11 gusht 2000, dhe të nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt.16.3.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.05.2007, merr

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E SHTATORES TË PRESIDENTIT TË SHBA-ve BILL KLINTON

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të presidentit të SHBA-ve Bill Clinton.

Lokacioni, nga par.1 i këtij neni, gjendet në bulevardin “Bill Klintoni” në këndin e udhëkryqit me rrugët “Tirana” dhe “Idriz Seferi” në Prishtinë.

Neni 2

Ky Vendim paraqet bazë për lëshimin e lejes urbanistike për hartimin e dokumentacionit teknik për vendosjen e bustit, nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 3

Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë do të kryejë veprime procedurale nga përgjegjësia e tij për shënimin e lokacionit, të caktuar sipas këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.353-202 dt.17.05.2007

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri